

## E DIELA E TE VERBERIT

## THIRRTORET, T. T. I.

*Këndohen dhjetë, domethënë shtatë të Tingëllit T. T. I, edhe dy prej të Verberit, dyke përsëritur të parën:*

## PAS IKOS TU EFRATHA, T. II

Vallë pse jam pa sy? Nga faje prindërsht nofta? I verbëri pyeste, dhe Krishti i përgjigjej: Kështu fitonj lavdi me ty. (2 herë)

“Lahu në Silloam, dhe sytë do të çelen! E bëra dhe shikova, dhe Krishtin lavdërova, si mjek të mëkatarëve.

“LAVDI. “A më beson tani?” E gjeti e pyeti, në Shenjtëroren Krishti, i verbëri përgjigjet: “Besonj që vetë Krishti je.”

TANI, T. T. I. Tejt në Det të Kuq një herë . . . (Shiko në Kremtoren, f. 103)

## PASVARGJET, T. T. I.

O i mëshiruar Jesu Perëndi, që nukë je ndarë nga Trinia, ty të madhështojmë dhe të falemi, se ke duruar Kryq dhe vdekje mi dhenë, për ne o Zoti Krisht, njeridashës lavdi më ty.

*Pastaj këndohen Vargëzimet e Pashkës, dhe Lavdia e ditës:*

LAVDI, T. T. IV. O diell mëndor i drejtësisë, o Krisht o Perëndi, që ia çele sytë të verbërit prej lindjes, ndriçonaji sytë e shpirtit edhe neve, tregona bij të dritës. se thërresim me besë: Njeridashës lavdi më ty.

TANI, T. T. I. Ardhi dit' e shenjt' e Ngjalljes . . . .

*Pastaj Përlëshoret e Tingëllit. Në Shërbesën e Mëngjezit, Ndënjësoret, Dëgjimi, dhe Shkallesat e Tingëllit, pastaj:*

## SHKURTORJA, T. IV.

## PAS EPEFANIS SIMERON

I verbuar plotërisht, nga syt' e shpirtit, ty të vinj o Krishti im, posi i Verbëri n' Ungjill, dhe i penduar thërres me lot: Ndrith-më në t' errët, o drita e qiellit.

## SHTEPIA

Dhuro-më dritën e urtësisë, o Krisht o Perëndi, që ta tregonj çudine e të Verbërit, të cilit ia çele sytë, edhe të thirri me besë: Ndrith-më në t' errët, o drita e qiellit.

## SINAKSARI

Gjithë sot, të Dielën e Gjashtë pas Pashkës, kremtojmë çudinë e të Verbërit prej Lindjes, që bëri Zoti dhe Perëndia dhe Shpëtimtari ynë Jesu Krisht.

Me dhëmpshërinë e pakufishme, o dritëdhënësi Krisht, o Perëndia ynë, mëshirona dhe shpëtona. Amin.

## ZBRITESORET, T. T. I.

## TO SOTIRI THEO

I. Shpëtimtar Perëndi, që nga deti në stere, përtej e shpure tërë popullin, dhe ushtërin' e Faraonit e përmbyste krejt, të hymnojmë besërisht, o Zot lavdi më ty.

III. O Zoti Krisht me forcën, e Kryqit të Çemuar

mëndjen ma ndriço, që ta hymnonj dhe ta lavdëronj, Shestjen tënde të çudiçime.

IV. Kam dëgjuar me gëzim, fuqin' e Kryqit tënt o Zot, që Parajsën e ka çelur, edhe thirra me zë math: Zoti i fuqishim lavdi më ty.

V. Të thërresim që menatë: Zot na ndih dhe na shpëto, se të kemi Perëndi, veç teje s' njohim tjetër Zot.

VI. Avush' e zezë më rrethoj, balena për mua u-bë si varr, po të thirra ty o njeridashës, dhe dora jote më shpëtoj o Zot.

VII. Të tre Djemat i shpëtove, që në flagë të këndonin, i bekuar je o Perëndi i Atërve.

VIII. Birin që lindi prej Atit, Shpëtimtarin Jesu Perëndi, të mishëruar në kohët e përfuntme prej Marisë për ne, priftërinj e hymnoni, e përmilartësoni, përherë dhe për jetë.

IX. Ty o Nën' e Perëndisë përmi çdo kuptim, ty që linde të pakohëshim, në kohe pa tregim, po të madhështojmë o Hyjlindëse.

*Pastaj këndohet Ungjilli Mëngjesor VIII (shiko Kremtoren f. 148), dhe Madhështimet e Pashkës.*

## DERGIMESORET, T. II

### SARKI IPNOSAS

Si fjete si njeri me trup, o Mbreti ynë Zoti Krisht, u-ngjalle të tretën ditë, dhe ngrite gjyshin Shën Adam, dhe e dërmovë vdekjen krejt, Pashkë burim i jetës, shpëtim i besnikëve.

Ndriçoji syt' e shpirtit tim, që m' u-verbuan plotër-

isht, nga mjegulla e mekatit, çel-i me bes' e dashuri, shëroji me përunjësi, laji me lot pendimi, o Zot i mëshirave.

## LAVDERIMET, T. T. I.

*Këndohen tetë, domethënë katër të Tingëllit, katër të Pashkës së Madhe, pastaj:*

LAVDI, T. T. IV. Kush munt t'i tregonjë, dhe kush munt t'i nëmëronjë çudirat e tua o Krisht? U-çfaqë në botë me dy natyra, si njeri dhe si Perëndi, edhe u dhurove njerësve dy shërime, se të verbërit ia çele, edhe syt' e shpirtit. Përandaj ay të lavdëroj si Perëndi, që u fale të gjithëve përdëllimin e math.

TANI, T. T. I. Ardhi dit' e shenjt' e Ngjalljes . . . .

*Doksollogjia e Madhe, pastaj Mesha e Shën Joan Gojartit. Në Hyrjen Përlëshorja e Tingëllit, Hyrtorja dhe Shkurtorja e Pashkës, Hymni Trishenjtor, pastaj:*

## APOSTULLI

Ti, o Zot, na ruaj dhe na përkrah.

Shpëto-më, o Zot, se humbi oshënari.

Këndimi prej Akteve të Apostujve.

Më ato ditë, kur po shkonim të falëshim, na hasi një vajzë, e cila kishte demonin e Pythonit, edhe u sillte shumë fitime të zotërve të saj, dyke divinuar. Kjo i ra pas Palit edhe neve, dhe thërriste dhe thoshte: "Këta njerës janë shërbëtorë të Perëndisë së lartë, dhe na tregojnë udhën e shpëtimit." Edhe këtë gjë e bëri disa ditë me radhë. Edhe Pali u-mërzit, edhe iu-kthye

demonit, edhe i tha: “Të urdhëronj më emrin e Jesu Krishtit të dalësh prej saj.” Edhe demoni dolli më atë çast. Edhe të zotërit e vajzës, kur panë se u iku shpresa e fitimeve, e zunë Palin edhe Sillën, edhe i shpunë në treg përpara qeveritarëve. Edhe i prunë përpara gjykatësve, dhe thanë. “Këta njerës na trullojnë qytetin, si Judenj, se lëçitin zakone, të cilat ne, si Romanë, nukë mundim as t’i pranojmë as t’i ruajmë.” Edhe turma u-sulnë kundër tyre, edhe gjykatësit i çuarnë robot, edhe urdhëruan që t’i rrihnin. Edhe passi i rrahnë shumë, i hothnë në burg, edhe e porrositnë burgëtarin t’i ruante mirë; edhe ay, posa e mori këtë porrosi, i hodhi në burgun më të thellë, edhe ua lidhi këmbët me branga. Po nga mezi i natës, Pali dhe Silla falëshin edhe lavdëronin Perëndinë; edhe të burgosurit i dëgjonin. Edhe befas u-bë një tërmet i math, sa u-tronditnë themelitë e burgut; edhe menjëherë u-hapnë të gjitha portat, edhe u-zgjithnë vargonjtë e të gjithëve. Edhe kur u-zgjua burgëtari, edhe i pa të hapura portat e burgut, e nxori shpatën, edhe gatitej të vriste veten, dyke kujtuar që i kishin ikur të burgosurit. Edhe Pali i thirri me zë të math, edhe i tha: “Mos i bëj vetes nonjë të keqe, se që të gjithë jemi këtu.” Edhe ay kërkoi dritë, edhe u-sul brënda, edhe u ra nër këmbë Palit edhe Sillës. Edhe i shpuri jashtë, dhe u tha: “Zotërinj, ç’ duhet të bënj që të shpëtonj?” Edhe ata i thanë: “Besojë Zotin Jesu Krisht, edhe do të shpëtosh ti edhe shtëpia jote.” Edhe i predikuan fjalën e Zotit ati edhe njerësve të shtëpisë së tij. Edhe më atë orë të natës ua lau plagët e rrahjeve, edhe u-pagëzua menjëherë ay edhe njerëzit e vetë. Edhe i shpuri në shtëpi, dhe u shtroj sofrën, edhe u-ngazëllua, edhe e besoj Perëndinë me tërë shtëpinë e vetë.

## UNGJILLI PAS JOANIT

Më atë kohë, tek po shkonte udhës Jesuj, pa një njeri të verbër që prej lindjes. Edhe dishepujtë e tij e pyetnë, dhe i thanë: “Rabbi, cili mëkatoj, ky apo prindërit e tij, që ka lindur i verbër?” Edhe Jesuj u-përgjeq: “As ky mëkatoj, as prindërit e tij, po kjo u-bë që të çfaqen veprat e Perëndisë mi atë. Edhe sa është ditë, unë duhet t’i mbaronj veprat e ati, që më ka dërguar; se vjen nata, kur askush nukë munt të punojë. Sa jam në botë, jam drita e botës.” Passi tha këto fjalë, pështyri përdhe, bëri baltë me pështymën, edhe ia lyejti sytë të verbërit me baltën, edhe i tha: “Shko, lahu në liqenin e Silloamit,” e cila e përkthyer domethënë i Dërguari. Edhe i verbëri shkoj, edhe u-la, edhe u-kthye me sy të çelur.

Fqinjte, pra, dhe ata, që e kishin parë të verbër më parë, thoshnin: “A nukë është ky, që rrinte, edhe lypte udhës?” Të tjerë thoshnin që: “Ky është.” Të tjerë prapë thoshnin që: “I shëmbëllen ati.” Po ay vetë thoshte që: “Unë jam.” Edhe ata e pyesnin: “Si të janë çelur sytë?” Edhe ay u-përgjeq edhe tha: “Një njeri, i quajtur Jesu, bëri baltë, dhe m’i lyejti sytë, dhe më tha: ‘Shko në liqenin e Silloamit, edhe lahu.’ Edhe unë shkova, edhe u-lava, edhe pashë.” Ata, pra, e pyetnë: “Cili është ay njeri?” Edhe ay u-përgjeq: “Nukë di.”

Ahere ata e shpunë njerinë, që ishte i verbër më parë, përpara Farisianëve, se atë ditë, kur Jesuj bëri baltë dhe ia çeli sytë të verbërit, ishte e Shtunë. Pra, e pyetnë përsëri edhe Farisianët qysh iu-çelnë sytë. Edhe ay u-përgjeq: “Më vuri baltë mi sytë, edhe u-lava, edhe pashë.” Edhe disa prej Farisianëve i thanë: “Ky

njeri nuk është i Perëndisë, se nuk e mban të Shtunën.” Të tjerë thoshin: “Si munt një njeri mëkatar të bënjë të këtija çudira?” Edhe u-bë një çarje në mes të tyre. Pra, e pyetnë përsëri të verbërin: “Ti ç’ thua për atë, që t’i çeli sytë?” Edhe ay u-përgjeq se: “Eshtë Profet.”

Po Judenjtë nukë besonin se ay ishte i verbër edhe iu-çelnë sytë gjer sa thirr në prindërit e tij, edhe i pyetnë: “A është biri juaj ky, që thoni se ka lindur i verbër? Qysh, pra, tani sheh?” Edhe prindërit e tij u-përgjeqnë, edhe thanë: “Dimë që ky është biri ynë, dhe që ka lindur i verbër, po nukë dimë qysh tani sheh, as nukë dimë cili ia ka çelur sytë; është i rritur nga mosha; pyeteni atë, edhe le t’jua tregonjë ay vetë.” Edhe prindërit e tij folnë kështu, se ndruhëshin prej Judenjve; se Judenjtë ishin marrë vesh që ta nxirnin jashtë sinagogjës cilindo, që do ta njihje Jesunë si Krisht. Përandaj prindërit e tij thanë që: “Esht i rritur nga mosha; pyeteni atë vetë.”

Pastaj e thirr në përsëri njerinë, që ishte i verbër, edhe i thanë: “Lavdi pastë Perëndia, e dimë që ay njeri është mëkatar.” Ay, pra, u-përgjeq, edhe tha: “Nukë di a është mëkatar; një gjë di vetëm, që isha i verbër, edhe tani po shoh.” Edhe ata e pyetnë përsëri: “Ç’ të bëri, si t’i çeli sytë?” Edhe ay u-përgjeq, edhe u tha: “Jua tregova një herë, dhe nukë më besuat. Përse doni t’jua tregonj përsëri? Apo mos doni të bëheni edhe ju dishepuj të tij?” Edhe ata e shanë, dhe i thanë: “Ti je dishepull i tij; ne jemi dishepuj të Moisiut. Po nukë dimë nga është ay t’jatri.” Edhe ay u-përgjeq, edhe u tha: “Eshtë çudi që nukë dini nga është, po ay m’i ka çelur sytë. Edhe e dimë që Perëndia nuk i dëgjon mëkatarët, po i dëgjon ata, që e nderojnë, edhe ia mbaroj-

në dëshirën. Kurrë nuk është dëgjuar më parë që dikush ia çeli sytë një njeriu, që kishte lindur i verbër. Sikur të mos ishte njeri i Perëndisë, nukë do të muntte ta bënte këtë çudi.” Edhe ata iu-përgjeqnë dhe i thanë: “Ti ke lindur në mëkata të tërë, edhe ti na jep mësimë?” Edhe e nxuarnë jashtë. Edhe Jesuj dëgjoj që e nxuarnë jashtë, edhe e gjeti, dhe i tha: “A e beson të Birin e Perëndisë?” Edhe ay u-përgjeq edhe tha: “Cili është, o Zot, që ta besonj?” Edhe Jesuj iu-përgjeq: “Ay, që flet me ty tani, ay është, po e ke parë edhe t’jater herë.” Edhe ay tha: “E besonj, o Zot.” Edhe iu-fal.

*Pastaj Mesha vazhdon dhe mbaron si të Dielën e Myrrë-prurseve.*